



Partizani luan nje tjeter ndeshje ne shtepi dhe perballe ka nje tjeter skuader simpatike. Pasi kaloi Kastriotin me rezultatin minimal, trajneri i demave Hasan Lika e di se nuk do te jete e lehte perballe Lacit. "Nuk eshte ndeshja qe percakton sezonin dhe per ne nuk eshte nje finale por eshte nje takim qe duhet fituar. Kemi nje ecuri pozitive ne javet e fundit dhe duhet ta ruajme ate. Shpresoj qe te kete sa me shume tifozes qe na perkrahin pasi ekipi ka bere nje pune te mire dhe meriton mbeshtetje maksimale. Laci eshte nje skuader e forte qe do te na krijoj probleme por ne i kemi marre masat per kete. Kam besim se do ja dalim. Skuadra ime synon Europen ndersa per renien nga kategoria ju them me bindje se nuk jemi ne grupin e ekipeve qe rrezikojne", ka deklaruar Hasan Lika.